

Të nderuar të pranishëm,

Kam nderin që jam sot bashkë me juve për të përruar hapjen e zyrës së re qendrore të Bankës Raiffeisen. Investimi i juaj në këtë objekt është tregues i qartë i zotimit tuaj për të vazhduar edhe në të ardhmen operimin me sukses në sistemin bankar dhe atë jo-bankar të Kosovës.

Banka Raiffeisen ka luajtur rol shumë të rëndësishëm në krijimin e një sistemi financiar të sigurtë dhe të shëndoshë, i cili ka kontribuar në rritjen ekonomike të Kosovës. Në jemi shumë të nderuar me prezencën tuaj dhe suksesin që keni treguar deri më tani dhe shpresojmë që do të vazhdoni me këtë sukses edhe në të ardhmen.

Banka Raiffeisen ka kontribuar shumë në zhvillimin e një konkurrence të drejtë, përmirësimin e vazhdueshëm të produkteve si dhe zhvillimin e produkteve të reja, duke rritur qasjen në financa, ka kontribuar në zhvillimin e marrëdhënieve tregtare me vendet tjera, ka ndihmuar në tërheqjen e investitorëve të huaj si dhe në përmirësimin e reputacionit të Kosovës në përgjithësi. Për këtë në ju jemi falënderues.

Banka Raiffeisen gjithashtu ka ndihmuar zhvillimin e kapitalit njerëzor, dhe vazhdon të shfrytëzoj potencialin e rinisë tonë. Ndër të tjera Banka Raiffeisen mbetet shembull i një punëdhënësi të mirë, gjë me të cilën në të gjithë jemi krenar.

BQK-ja si mbikëqyrës i sistemit financiar do të vazhdoj të punoj në mbajtjen një sistemi financiar të sigurtë dhe të shëndoshë dhe do të përmirësoj vazhdimisht mjedisin ekonomik, në të cilin industria financiare operon.

Spektori financiar është një sektor me dinamikë të madhe të zhvillimit dhe ndryshimeve të shpejta në mjedisin ekonomik që e rrethon atë. Sistemet financiare të vendeve të ndryshme po integrohen vazhdimisht dhe kjo

kërkon rritje të bashkëpunimit ndërmjet këtyre vendeve. BQK-ja mbetet e përkushtuar në bashkëpunim me qëllim të tejkalimit të sfidave në të ardhmen dhe integritet të sistemit financiar të Kosovës në sistemet e ekonomive të zhvilluara.

Bankat në Kosovë sikurse në të gjitha vendet tjera kanë status të veçantë në ekonomi. Ky status shoqërohet me kërkesa të ndryshme rregullative dhe kërkesa më të mëdha të përgjegjësisë sociale dhe kam kënaqësinë të them që bankat në Kosovë më sukses i përmbushin këto kërkesa.

Sot në Kosovë kursimet tona janë të sigurta dhe avancimet në teknologji na lejojnë që të kemi qasje me të shpejtë në to.

Bankat janë një shembull i suksesit në Kosovë, andaj u bëj thirrje që këtë sukses të tyre ta promovojnë edhe më shumë me qëllim të tërheqjes dhe rritjes së investimeve të huaja edhe në sektorë të tjerë. Kjo do të ndikonte në zhvillimin ekonomik, i cili është më së i nevojshëm për një stabilitet financiar, si dhe avancimit të mëtutjeshëm të sektorit bankar në të cilin Banka Raiffeisen luan një rol shumë të rëndësishëm.

Në fund ju falënderoj për zëmbërshëm për kontributin tuaj në zhvillimin ekonomik të Kosovës dhe ju uroj suksese në të ardhmen.